



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Бр./Nr \_\_\_\_\_

г./v. \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-9282/1 të datës 18.11.2022 me pretendime për parregullsi në -----, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, në denoncim nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve gjatë ushtrimit të pushtetit publik dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12-9282/1 të datës 18.11.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 18.11.2022, një parashtrues i panjohur ka dorëzuar denoncim me numër 12-9282/1, pas së cilës është ngritur lënda me pretendime për parregullsi në -----, -----, -----, ----- dhe -----.

Në denoncim thuhet se personat me kombësi shqiptare të punësuar në -----, -----, kanë marrë rregullisht udhëzime, përkatësisht urdhra për punën e tyre, nga partia politike -----. Parashtruesi thekson se nën ndikimin politik të partisë politike dhe pa bazë ligjore, janë zgjidhur të gjitha kërkesat për regjistrimin e të drejtave pronësore dhe kërkesat për privatizimin e tokës, të paraqitura nga aplikantët me kombësi shqiptare në -----.

Pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar, KSHPK-ja arrin në përfundimin se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme pa specifikuar persona dhe aktivitete të veçanta, domethënë nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, ndërsa KSHPK-ja nuk ka mundësi të japë informacion shtesë në lidhje me pretendimet në denoncimin (denoncim anonim).

Në bazë të konstatimeve, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka juridiksion për të vepruar në rastin në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: J.C.

Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHΤΕΤЉΡΟΡ  
ПЉР ПΑΡΑΝΔΑΛΙΜΙΝ Ε ΚΟΡΡУПСΙΟΝΙΤ**  
**Nënkryetar**  
**Katica Nikolovska**

